

BIBLIOTEKA

E

SHH-1
D 90

SHETIT

GJIROKASTËR

IZET
DURAKU

*Drini
i bardhë*

POEZI

SH-1
090

LIBRARY THOMAS
Kodifikatori

Izet
Duraku

33278

Drini
i Bardhë
p o e z i

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Redaktore

ISKRA THOMA

1. Redaktor	2. Redaktor	3. Redaktor	4. Redaktor	5. Redaktor	6. Redaktor	7. Redaktor	8. Redaktor	9. Redaktor	10. Redaktor
11. Redaktor	12. Redaktor	13. Redaktor	14. Redaktor	15. Redaktor	16. Redaktor	17. Redaktor	18. Redaktor	19. Redaktor	20. Redaktor
21. Redaktor	22. Redaktor	23. Redaktor	24. Redaktor	25. Redaktor	26. Redaktor	27. Redaktor	28. Redaktor	29. Redaktor	30. Redaktor
31. Redaktor	32. Redaktor	33. Redaktor	34. Redaktor	35. Redaktor	36. Redaktor	37. Redaktor	38. Redaktor	39. Redaktor	40. Redaktor
41. Redaktor	42. Redaktor	43. Redaktor	44. Redaktor	45. Redaktor	46. Redaktor	47. Redaktor	48. Redaktor	49. Redaktor	50. Redaktor
51. Redaktor	52. Redaktor	53. Redaktor	54. Redaktor	55. Redaktor	56. Redaktor	57. Redaktor	58. Redaktor	59. Redaktor	60. Redaktor
61. Redaktor	62. Redaktor	63. Redaktor	64. Redaktor	65. Redaktor	66. Redaktor	67. Redaktor	68. Redaktor	69. Redaktor	70. Redaktor
71. Redaktor	72. Redaktor	73. Redaktor	74. Redaktor	75. Redaktor	76. Redaktor	77. Redaktor	78. Redaktor	79. Redaktor	80. Redaktor
81. Redaktor	82. Redaktor	83. Redaktor	84. Redaktor	85. Redaktor	86. Redaktor	87. Redaktor	88. Redaktor	89. Redaktor	90. Redaktor
91. Redaktor	92. Redaktor	93. Redaktor	94. Redaktor	95. Redaktor	96. Redaktor	97. Redaktor	98. Redaktor	99. Redaktor	100. Redaktor

Redaktore
ISKRA THOMA

NE KËTE COPEZ TOKE

katundit ku u linda, Morinit

Si në veten time në këtë copëz tokë,
i përhershëm

në pranverë,

në dimër.

Flas me kundërmimin e plotë të lulevë,
me pluhnajën e dëborërave të ngrira.

Flas për dashurinë që endet midis njerëzve,
për dashurinë që ka për mua nënëmira.

Në këtë copëz tokë me gurë,

rrënjë,

ëndrra,

siç harrohen pranë vashës nganjëherë brengat,

harrova inatet e vogla me zënka,

gëzimet e vogla të ditëve të mia.

Mbajta veç gjërat më të shtrenjta,

ato që më dhimbnin po t'i hiqja.

Në këtë copëz të vogël Shqipërie
mësova të shoh dhe përmes mjegullës së dendur,
jo veç majën e fshehur të një lartësie,
a zemrën e shokut brenda brinjëve.
Mësova të shoh gjithë botën e vrenjtur,
trazirat që ndodhin kudo kufijve.

Flet kjo copëz tokë me veten time
me gjuhën e dhembshur të nënës fatkeqe.
Fëmijët iu rritën asaj me thërrimë
netve të errëta,
netve me leqe.

Flet kjo copë tokë me veten time
për ditët symprehta,
të kthjelltat agime.

NA U Rritën ENDRRAT

Ja, si fëmijët na u rritën ëndrrat,
plot zhurmë,
klithje të shëndetshme,
Nëpër duart tona e thellë brenda nesh
jetë merrkan
e ne prej jetës së tyre
gazin e dritën,
krejt trupin prej ëndrre
rritur sa gjithçkaja —
hapësirë e pakufi,

«Pak dritë,
pak dritë!»
donte vëllai ynë prej brengje
kohës së tij të verbër t'ia vinte si sy.
Pak bukë,
pak ajër,
pak dritë — rreze hënë;
si kutiçkë jeta për të.

E ne sot gëzohemi që jemi njerëzit
gur pas guri ngjitur te fjala Liri.
U zgjeroka bota kështu gur pas guri
dhe luftë pas lufte diej u bëkemi.

Rruzuj të ndritshëm ëndrrat,
rruzuj të vegjël
që jetën zgjojnë në rruzullin e madh.

E PËRDITSHME

Mes për mes i bie Drinit të Bardhë
për te nxënësit e mi
e s'marr shumë nga ai,
veç pak drita
nga miliona dritat e tij.

DRINI I BARDHË

poemë

1.

Parmakëve të hekurt të urës së madhe
flet me brigjet e lumit dhe të jetës
një malësor i moçëm dhe unë, poeti.
Pas nesh antena flet me qiejt dhe botën
fjalët e reja që kumton qyteti.
E poshtë në qetësinë e ujërave të mia,
mes rrudhash të turbullta e të kthjellta
flet me mua e me ty historia,
e sotmja dhe e nesërmja.

2.

Nëpër ashtin e fortë të maleve,
shtatin e butë të fushave,
plepishteve të pikëlluara,

shelgjeve,
kërcellit të brishtë të lules,
në rrumbullakësinë e bardhë të gurëve,
tulin e verdhë të bukës
dhe rrembat e sertë të njerëzve,
kam rrjedhur,
shkumëzuar,
vërshyer

me fare pak ujë
kulm e tallaz — etje;
etje gjatësisht,
mite,
gjakderdhje.

E në brigjet e mia ilegalisht rridhte jeta,
ilegalisht rritej me mua ndër rremba.
Qindra herë këtu kërciste vdekja,
qindra motra pastaj vajtonin Selmanin¹⁾ e tyre:
Unë tkurresha atëherë,
zbehesha,
ndalja krejt ujin
dhe lëshoja veç gjakun.
Pas gjakut këngët-varre

1) Hero i baladës veriore «Krisi pushka bregut Drinit».

me dritare të gjera për dashuritë e vëfara.
Loja e stinëve ndërronte kërshe e brigje
e nëpër dritare krejt të helmuara
dashuritë vërenin,
nuk duronin.
pa i dalë jetës krah.

3.

Dritare e diell, prapë dritare,
zhaurimë e lumit kurrë s'u ndal;
vetëm rrinte ngado rrjedhës,
kërkonte mbiemrin e bardhë.

Nëpër ashtin e fortë të maleve,
shtatin e butë të fushave
i bleroi emri shekujve të prapë
në rrembat e sertë të njerëzve.

Dhe prej stërgjyshit tim të stërlashtë
deri te rrembat e mi
në miliona dritare hapur nga këngët
miliona dashuri u dukën
me rrënjët në ujin e pakët,
shtatin në liri.

Kosiste vdekja anembanë,
por dilnin përsëri.

4.

Mbi trupin e kthjellët të Drinit të Bardhë
me një trap të thjeshtë kaloj çdo ditë
dhe veç kthjelltësisë në trupin tim
futen brigjet e dikurshme të dhimbjes
e brigjet e sotme të saj.

Ja, dëgjo britmën e motrës sime
për vëllanë e vrarë kosovar.

Në mua lumi tkurret, tash
zbehet,
ndal krejt ujin
dhe lëshon veç zemërimin.

Pas zemërimit — nëpër dritaret e tij
kosovari futka lirinë.

5.

Drini i Bardhë krejt i përtërirë
rend nga Komani e Fierza
për në takimin e dashurisë
jo me tufa lulesh në duar
po me drita.

Ashtu futet mbrëmjeve të qytetit të ri
e në trimërinë e vjetër,
portave plot zhurmë të uzinave
brenda bakrit të shkrirë,
trenave me mollë e hekur.

Në qumështin e gjalpin e mëngjesit,
te lodhja ime e ndershme gjatë ditës
e në trishtimin e njeriut të mirë
para trëndafilit të kuq
te koka e Hasan Prishtinës.

6.

Gurgullon butë Drini i Bardhë...
Po ku janë varret me dritare të gjera,
klithmat e motrës për vëllanë e vrarë?
Nën ujëra kanë mbetur pusira të vjetra
me dekrete të rrepta kanuni,
grindje të moçme kullash,

sheshi i xhamisë me hijen e gjatë të hoxhës
dhe lutja e qeleshebardhëve besimtarë.

Ujërat kanë larë shenjat e kobshme të luftës,
por dhembja ka mbetur mureve të ulëta;
me emrin e Merimanit¹⁾
ka mbetur përjetë edhe krenaria.
Nën dritaret e hapura, rrugëve të ngushta
bëri ditën e parë liria.

Ende ziejnë përvjetoret e saj atje në sheshin e
vogël,
rreth pedestalit të kuq të Kastriotit,
nëpër megafonët e vegjël flasin fitoret,
përplasen duart e mia,
që ruhen bankave të gjimnazit
dhe në ëndrrat që thur fantazia,
në lirikat e para rreth belit të dashurisë,
buzë lumit, në parkun «Rinia».

1) Dëshmorit Meriman Braja.

7.

Në oborrin e shtëpisë së re
malësori i moçëm nxori pushkën e fshehur.
Askush nuk shkuli flokët,
askush nuk ulëriu
veç nusja buzëqeshi si me pahir.

Po ai s'po pyeste për ironinë e saj,
s'pyeste për asgjë.

Krenar,
shtiu shtatë herë si në rapsodinë e lashtë
shtatë gjëmime të rënda mbi mosbesimin e tij.
Pastaj vari pushkën në supin e lartë
e drejt e në polici.

8.

Në pasqyrën gjigante të ujërave
nusja Gjalicë bën tualetin,
mëson të shohë më mirë vetveten.
Nga xhepi nxjerr krehrin
pastaj gërshërët e mprehta.

Dhe rrëzohen koriqe të dendura mitesh,
perëndi të mëdha e të vogla,
shkëmbinjtë të nxirë fisesh
e shpella legjendash të errëta.

Mbetën atje në Kukësin e Vjetër
shtëpitë e vogla me kopshte.

...Lëkundet muret me vargjet e qepëve,
erën e mollëve;

por apartamenti në katin e gjashtë
të gjitha këto i ka futur në dosje.

Merr toje e grepa, bëhet peshkatar,
jo krapin e ngjalat, po pronën e tij
liqenit t'ia marrë.

Ndërsa Gjalia krejt e ngeshme
vazhdon tualetin e saj.

9:

Malësorit të mocëm në rajonin e policisë
për armën e vjetër ilegale
i dhanë një pushkë flakë të re,
si krejt populli ta mbante në sy

përderisa ka egërsi shovinizmi përqark,
ethe të zeza fashistësh,
konferenca dhe superfuqi.

10.

Nesër Drini i Bardhë pret miq të largët,
lumenjtë e kuq, të verdhë a të kaltër
me ylbere stërkalash,
brohoritje të ndritshme ujëvarash.
Raportin e mban vetë liria
e pastaj kumtojnë baladat.
Fort e dhimbshme kjo baladë e Drinit,
fort krenare.
Në themel të kalasë së saj u përmyt
një qytet e dhjetëra fshatra.

Nesër Drini i Bardhë pret miq të largët
në sofrën e tij të zemrës, me bukë e kripë.
Bota përshëndet lumin me ujëra të pakta
e me kaq shumë dritë.

Dhe pret shiritin e «Vëllazërimit të ujërave»
epoka e komunizmit dhe e punës...
Me malësorin e moçëm ëndërron poeti
në parmakun e hekurt të urës.

11.

Gurgullon krejt i qetë Drini i Bardhë,
rrjedhën e tij asgjë s'e ndal,
as fjala e lashtë sa historia: tradhti,
as fjala e re: burokrat.

Vërshon ai në digëdritën e Partisë
dhe pret diga të tjera,
lëviz turbinat e fuqishme të jetës
kudo ngre shtylla të reja.

Emër i pastër në vështrimet e ditëve,
kthjellon edhe sytë e mi.
Me vrapin e sigurt të kohës sime
fitoi bardhësinë e emrit të tij.

33278

LIQENI I DRITËS

Me gjoksin e gjerë zbërthyer nën diell
Liqeni i Dritës përkundet n'ëndërrime.
Nga thellësia ngjiten do flluska të vogla
si sytë e ndritshëm të fëmijërisë sime.

Përsëri ajo endet brigjeve të lumit
me Zhyl Vernin e etur për kërkime.
Barkat më tej. Në to peshkatarët
hedhin peshkun dhe të miat kujtime.

LEGJENDA E EMRIT

Më pritën mua si dushku pret gjethin;
kish hyrë prilli me bar të njomë te porta,
nëna më lau me lulet e ftonjve,
me këngën e saj u mrekullua dhoma.

Një vit bërtita e qava i paemër,
se maleve s'u shqiteshin nga supet legjendat;
sa lindnin fëmijët i thërriste vdekja
e malet vdekjes ia fshihnin emrat.

Sa vetë si unë pagëzoi Drini i Bardhë¹⁾
duke i thirrur me zërin e lartë,
rrjedha e tij asnjëherë s'qe tharë
e malet fort e donin jetën e gjatë.

1) Ishte rit i malësorëve pagëzimi i foshnjave në Drin, që këta të kishin jetë.

Rridhnin ujërat e turbullt me rendjen e vrullshme,
me shkrirjen e borës, harenë e pranverës,
tek më binin në trupin e ngrohtë prej fëmije,
merrnin fytyrën e kreshpëruar të vdekjes.

Atëherë, thonë, më ish lidhur goja,
veç duar e këmbë përplasja i trembur.
Emrin po ma vinin në lumë që të rroja,
unë frikën e këtij lumi në zemër...

Ca krisma, më pas ca zëra të zgjatur
thirrën emrin tim fushës së malit.
po unë ndala së përplasuri këmbët
vetëm në krahët e babait.

Ikën përgjithnjë ritet pagane,
por s'po ikte mësimi i Drinit.
Futej pakuptuar në rrëfimet e nënës
mbrëmjeve të verës, netve të dimrit.

Û rrita një ditë e mësova të flas me valët,
me ato që pëshpëritën sa herë emrin tim,
mora vesh se s'u vinte keq që malet
s'i binin më fqshnjët për pagëzim.

B A B A I

Nuk të lë lumi i jetës,
hapur janë vorbujt e saj,
ikin prindërit pa e ndier
e tronditesh ti pastaj.

Varr i hapur në zemrën tënde,
hedh ti një dorë dhé,
dheu yt më nuk kthehet
bashkë me dorën është atje.

Dhe s'di ç'të bësh me atë dorë,
nuk u ngrohka dhé i ftohtë,
për të ngricat paskan rënë,
ndërsa dielli ndrin në botë.

Atë dorë ua jep shokëve,
fshin me të lotët e fëmijëve.
E nga dheu drita të vogla
pas ndjekin me mijëra fije.

Unë s'e pashë të vdekur — kurrë s'do
ta shoh kështu,
ja ky dhë i imët, ja këta dy gurë.
Rroi ai siç rron njeriu,
vdiq po ashtu.

Shtatvogël, superënë,
gjysmën e jetës të zezë, gjysmën
të bardhë,
Tani të gjitha m'i ka lënë,
u harrofsha po s'dita t'i mbaj.

Dhe toka, pa shih, u bëka më e rëndë,
si të ikësh prej vetes të ikësh prej saj!

SHIU ËSHTË ATJE LARG

Tani mbeti prapa fshat i largët mes malesh
e nënë e bardhë mbeti prapa
dhe në ëndërr e zbehtë më shfaqet
me vetëtimat e mallit
e brengën e saj prej nëne.

Shiu është atje larg.
Nga njeriu i shurdhër
trokitja s'dëgjohet fare.
Po unë e ndiej atë në xhame,
te dritarja e dhomës dhe zemrës sime
që vishet me avull.

Puthja e ngrohtë është aty,
pemët dhe gjithë kuqëlimi
i gjakut të saj në rrembat e mi,
ku s'gjen vend harrimi... shurdhimi.

MË KA MARRË MALLI

Më ka marrë malli për dorën tënde
të ngrohtë që zë dorën time,
për ajrin që ti thith dhe buzët e tua
që mbyllen pas kafshimit të mollës.

Më ka marrë malli për gjoksin tënd
të plotë që ruan plot dëshira,
për gjithçka që ti sheh dhe sytë e hapur
që sjellin pranverën.

Më ka marrë malli për flokët e tu
të dendur që digjen në sytë e mi,
për bukën që ti ha dhe rrjedhën e ujit
që të duket në qafën e gastartë.

Më ka marrë malli për krejt qenien tënde
të pazëvendësueshme ku fle vazhdimi im,
për tokën që ti shkel dhe hapin e lehtë
që hap ditën e nesërme.

PEIZAZH DIMRI

Me re e zogj të vetmuar
qielli i trazuar i dimrit,
digjen zbehtë puplat e trishtuara
nën syrin e largët të diellit.

Dhe nisin bjeshkët të luftojnë
stuhinë që s'është larg.
Të trembur zogjtë të parët ikin
të gjithë nga Jugu, varg.

E ty, vogëlush, t'u pritkan gjunjët
për pak diell e ngrohtësi,
po i kërkon ato me ngulm,
si zogjtë në hapësirë.

Nga lodhja u plak, sigurisht,
ky qielli ynë i mirë,
kudo e veshi, sytë ia përloti
Veriu me erën e ngrirë.

Pastaj mbi gjithçka rrëzohet
ngadalë dëbora e bardhë
Edhe nën të me ngulm toka
e ruan krenarinë e saj.

MARS

Iku bora. Gjurmët e saj
ende shquhen bri honeve, shpellave.
Veç në maja dimri i vonuar
edhe një herë lëshon turrin e erërave.

Por asgjë. Gjymtyrët e plakura
s'i ndihmon as inati i verbër.
Pas shkollës, pakëz e harruar,
diçka pritka edhe arra e vjetër.

Nxënësit e ndoqën vështrimin tim
xhamave të dritarës. Të panë edhe ty
flokëlëshuar pemëtoreve, grunajave
tek vije, pranverë, me diell e shi.

ME AUTOBUSIN E PARË TË MËNGJESIT

Dy sy të mprehtë drite gjatë therin terrin.
Uturimë e dridhur, e çuditshme
si kjo bardhësi e butë shkërmoqur nën rrota.
Mijëra fluturza dëbore me lutje për falje
papushim ulen në dritaret tona
e ne gjithnjë fshijmë xhamin me pëllëmbët e
ngrohta.

Sërish fluturzat e dëshpëruara
për të na prekur, ndoshta, lënë gjurmët e lotëve
Por ne s'kemi kohë.

Në agun e turbullt shfaqen format e rënduara
të hendeqeve, plepave, arave të posambjella
e diku anash vargu i gjatë i punëtorëve
Tani ngado të bardhat balerina
kërkojnë shpjegime me puthje të ftohta.

Por ata s'kanë kohë.
Pret uzina me duar të mëdha avullí,
e para nesh akoma
lumi i përgjumur, kodrat, miniera.

DITËT DHE NETËT E NJË KANTIERI

Ditët dhe netët mbajnë ngrohtësinë e djersës
në zhurmën e gurthyeseve, betonierës,
në dridhjet e vibratorëve, zjarrin e saldatriçeve
e bukën e bardhë të mensës.

Ditët dhe netët mbajnë ngrohtësinë e njerëzve
në sytë me diellin e sigurisë,
në tingujt e fjalës së kthjellët — mirupafshim
e takimet e vrullshme të dashurisë.

Ditët dhe netët mbajnë ngrohtësinë e jetës
në çapat e pleqve, duart punëtore,
në ëndrrën e bukur të fëmijës, qeshjen e tij
e dritat e përhershme në varret e dëshmorëve.

BJESHKËT E NEMUNA PËRCJELLIN TË RËNËT

O pse po ikni ju, gëzime të rralla,
ju kënga më e mirë e trimërive?!
A nuk ju mbanin këto maja të larta,
telat e sharkisë,
të çiftelive?!

Radhë-radhë u përkulkan Bjeshkët e Nemuna
dhe sytë u rigojnë vetëtima brengje.
Lehtë-lehtë, pa shih,
vijne me afsh ca zëra —
fort mirë e dimë se jemi bijtë e një nëne,
nëpër të lëvizim,
prapë jemi brenda!

BANORËT E PARË TË KUKËSIT TË RI

Bungaja fliste ende me gjuhën e lashtë,
ne gjëra të reja ndërtonim nëpër ëndrra.
Në gjakun tonë ju, syri që vrojtuat
se mos ngatërrohet e ngel nëpër udhë kënga.

Mermer i lëmuar,
mermer i kuq,
llamba që digjen kurora qarkuar.
Te koka secilit nga një trëndafil,
në projektudhët e nesërme hapi juaj.

E mori kështu gjithçka të re Kukësi i Ri
tek erdhët ju një nga një,
siç ratë nëpër maja,
te kjo lagje kaq e domosdoshme
për sytë e kthjellët që ka e ardhmja.

DËSHMORIT GANI

SHKURTIM I 1977-78

Kërrabën në dorë, një tufë dhensh përpara;
brigjeve, lugjeve, rogave të blerta,
poshtë digjej buka nëlara,
digjej vetë jeta

prush e shkumb, zjarre,
hutohen dhentë e shkreta!

Po njeriu?

Një tufë esesësh vë përpara;
turret si Drini mbi flakët e tokës,
uji i zhurmshëm,

i freskët

e tokë e zhuritur thëthim lëngun e bjeshkëve.

Mbin,
rritet liria
vaditur me jetën e njerëzve.

GURI I SHPUAR

Nga zemra e dheut gatuar me klithma,
me gjak baladash e lotësh vezulime,
u ngrit si digë për vërshimet e idhta
kjo rojë e moçme e tokës sime.

Veten e breu ngadalë me dhëmbë
në terrin e jetës me ngricë e shtrëngatë.
Pas dhembjesh të gjata në parzmin e rëndë
u hap dritare madhështorja plagë.

Dhe thanë rreth e rrotull se tash ai vdiq,
dhe thanë rreth e rrotull nuk e ka të gjatë,
emrin ia qëlluan me-net e me ditë
e më i sertë ai, më fort i lartë.

Dhe prapë bëri jetën ashtu i përgjakur,
rriti Drenicën, Gjakovën e Lumën,
gjithnjë pranë tij nga dritarja e hapur
në këmbë të vrojtonin pa harruar luftën.

Jo, më kot s'e kish brejtur veten,
shkretime të reja që larg murmurin.
Të mos i trazonin nga prehja të rënët,
të gjallët e tokës syçelë të ish-in!

MOS E PREK MËNGJESIN TIM

Prej syve të përgjumur të turnit të natës
mëngjesi rrodhi me zhurmën e blerësve të
qumështit,

qelqeve të dridhshme të dritareve,
dhe solli shtriqjen time,
rrjedhjen e gëzueshme të qezmës,
bisedën e shpejtë me pasqyrën dhe fjalët
e trishtuara të krehrit me thinjat e rralla,
avullin e ngrohtë të kafes
dhe udhën e përditshme me librat e pakta...

Gjithmonë ke dashur mbi buzën time të plasur
në vend të ujit plumbi të rrjedhë,
ti, armiku im dhe i gjithë njerëzve —
shtirje mijëravjeçare...

Mos e prek mëngjesin tim me gishtat e tu të
akullit!

Mbrëmja tani duket krejt e largët
e, që ta dish,
prej teje s'vjen fare.

Atë e kërkojnë dashuritë e drojtura
që ndizen në magjitë e takimit,
shëtitorët e uritura që kërkojnë rimbushjen,
tryezat familjare të bukës,
seria televizive e filmit..
Mbrëmja rritet në lodhjen e ditës
që kërkon të teret çasteve të pushimit

S'ka nevojë për ty as silla, as darka.
Ti rri atje ku je —
te vjetërsia.
Zeus që vran e kthjell sot është njeriu,
jam unë me shtigjet e mia
të shenjta si fjalët «bësë» dhe «nder».
Shoh në sy këdo pa m'u skuqur fytyra
e skuqjen e shëndetshme kam ngaherë.

MESNATË E DASHURUAR: DHJETORI

Mjafton pak flakë për të ngrohur duart,
pak flakë për këmbët e ngrira,
gjuhëza të verdha,
pak prush i kuq,
të qeshë dhe mes tymit e mira.
Vërtet, sa pak dashka dashuria,
pak zjarr,
një copë truall nga lëndina,
një pushim të vogël mes punës,
Qielli është
yjet me mijëra...
Dhe ti të harrosh paksa në zemrën e tjetrit,
në ngrohtësinë e tij njerëzore
e të mos dëgjosh klithjet e erërave.
Mjaftojnë pak flakë për të ngrohur duart
pak fjalë për të njohur tjetrën,
veç pak drurë u dashkan për zjarrin.
Për fjalët duhet të japim vetveten.

NË UDHËN E VJETËR

I

Shermashekët lëvizën, muret gjithashtu;
nga blerimi, si prej ujërash të thella,
u shfaqe ti.

Me leshrat e verdha luan era
dhe jam nën të njëjtin diell, po nën qiellin blu.
Zgjohen hapat e mi, të zbehtë, vegime
me regëtimën e ditëve të shkuara;
në pjesën e harruar të vetes sime
sërish krah njëri-tjetrit të hutuar
ëmbëlsisht u dehemi në verën e fjalëve,
në verën e ëndrrave.

Veçse ndërkohë kjo udhë ka mbaruar
e blerimi sikur s'ngjan më me ujërat e thella,
as ti nuk je;
e trishtuar pushon dhe era,
pushoj pakëz në bulëvardin e gjerë.

II

Ngado nxitojnë njerëzit rrugëve nën shi,
bri tyre eci pa u ndalur;

ndonëse ti u ndale e ike
në tjetër udhë, nën mjegull e avull.

Ja, po shoh mes trishtimit ujon
si tretet pjalmi i ditëve tona,
mbrëmjet e buta, pylli vjeshtor.

Nga buzët fletë-fletë, si gjethe të vona
bien betimet, singeritet i dhembshur
e një pikë malli pikon zemrën.

Gërryen kjo pikë në heshtje, e fshehur
cipën e hollë, të ftohtë të harrësës.

Ngadalë hap ajo një dritare —
qiell të lartë, e nën këtë qiell
hapat e dashurisë sonë të dëlirtë,

supet e saj, e mbi to
dora e botës së madhe.

Rëndon kjo peshë mbi brishtësinë
me akujt, shirat, erërat e lagëta.

III

Kështu mbete prapa në udhën e vjetër
bashkë me dritën e syve të mi për një çast.

Koha sheh e vrenjt ballin e madh
unë shpejtoj bri njerëzve,
vë buzën në gaz.

shprehë ashpërshë qorq së cil
shprehë të gjithë të mirë
të cilët që të shprehë
shprehë të gjithë të mirë

PO NUK ERDHE...

Mbijnë tek unë shumë ëndrra:
Ç'diej...
Ujëra të kristalta,
vendi im gjithkund përçark
erë njerëzish,
fjalë,
hapa,
hapat tanë që eojnë bashkë.

Po nuk erdhe ti me mua
diç do dhembë,
do rroposet duke klithur
brenda gjoksit, brenda zemrës,
zverdhur ftua për pak kohë,
ndoshta gjatë...

Po ja prapë lulokan ëndrra,
ikin veç idhuj të rremë.
Koha ime, ti je hapi
sipër tyre që shkel rëndë!

PO NUK ERDHTE...

Mijmë tek unë shumë ëndrra:
Q'biej...
Ujta të kristalishtë,
vendim gjatë kohës përparë,
erë njerëzish,
tjërë,
hapat tanë që ekin bashkë,
Po nuk erdhe ti mëmë,
diç do dhembë,
do troposet duke kllithur
brenda gjokut, brenda zemrës,
zverburim tua për pak kohë,
ndoshta një...

FUSTANI I BARDHË

Përqark shoqet e ti po ndahesh sipas rritit të
lashtë,
ndryshon veç fustani i ngushtë, i bardhë
edhe fati yt po aq i bardhë, motra ime.
E megjithatë paska përsëri pse të qash...

Ja, po fluturon ngadalë
në qiellin me re të vjeshtës së vonë,
në qiellin e dasmave, vajzëria jote.
E në zemrën time tash zhurmon
taksia e nusërisë sate.
Motër, udhambarë!

Kjo vjeshtë ndryshe s'do të ishte kaq e pasur,
kaq e bukur as jeta, kaq e bardhë.

NDRYSHE S'DO TËRLISJA KËSHITUR

Mua më vjen keq për ty, vëllaim,
në djeg shpirti.

Shihmi flakët e hidhura më për asy, por ndaj t'bu
në plasat me buzëve të ty, ps oq ty itat e kë
shihma helmin q'ima. Arëq e larq e stadijton e
Po kraharori s'u çaka,

zemrën ti të ma shohësh,
zemërbrengën që rreh për mërinë e ty oq ka.

Ndryshe duart e tuat do t'i quaja sërish i duarën
larg mjegullës dhe të lakmisë e rillat e m
dhe zërin tënd, të bukuri: zë, të shpirtit të ty
zë vëllai sërish do ta quaja. S'është e shpirtit
lëndë e ty e kë.

Prindërit e tu në fshatin e largët, s'është e ty
të tutë akoma janë — s'është e ty e kë
njerëz që më këmbin stinët dhe jetën.

Ata s'heqin dot lehtë dorë prej teje
por duan të vërtetën.

Ndërsa ti atje në qytetin e madh,
në prehrin e ngrohtë të një zyre,
ke këmbyer gjithka të sinqertë
për një ëndërr të ndritshme farfuritëse,
për të ndërruar «emrin tënd të vockël»,
«postin e paktë, të mërzitshëm»!

Mua më vjen keq për ty, vëllai im,
më djeg shpirti.

Në ç'kalë kështu ti paske hipur,
mbi ç'potkonj të tmerrshëm
e nuk shikoke thundrat e tua nëpër trupin tim?!
O ç'rendje e kobshme
kuturu për të kapur lavdinë!
Po kraharori s'u çakaq
zemrën ti të ma shohësh,
zemërbrengën që rreh për njerinë.
Ndryshe atij kali do t'i zbrisje
kokulur para nderit
e në të kuqtë e faqeve sërish do shihnim
njeriun që shpëton prej vrerit.

BISEDË TELEFONIKE

Midis nesh fshatra e qytete veriore.
Malli ynë qindra kilometra i gjatë.
Nga respekti për të
orteqet heshtin në mal.
Dhe telat, miku im, midis nesh
gjithkund ndehen sipër tokës.
E mbahen më fort se te betoni i shtyllave,
te dashuria e Pjetër Llesh Dodës.

HIMARE 1980

Filikuri feta-feta
kridhu mik prej lartesisë,
fërgëllon kurmin e dridhshëm
vetë zemra e kaltërsisë.

Hidhu, mik, nga majë e shkëmbit
por kujdes prej kthjelltësisë,
ka rrezik; aty me veten
dashurohesh si Narcis.

Në pasdreke shtëhet era
veçse uji rri i qetë,
këtu paska pikëpjekjen
dashuria tokë-det.

KTHJELLTËSIA E MALEVE

Kam kaluar në gryka e hone
për në grykat e tua,
Valbonë e kaltër.
Kudo më lëvrin ndër rremba
kthjelltësia e maleve.

U nginja në ujërat e ftohta,
kokën mes valësh kredhur.
Ndjeva
shushurmën e ëmbël të zajeve,
freskinë e mijëra e mijëra këngëve
që këndohen
e do të këndohen në këto male.

LAHUTES

Vinin vitet me piskamën e çjerrë,
nëpër telin tënd peshonin,
ngjireshin vitet,
skuqej teli nëpër mortje,
nëpër lindje.

Vetëtinte në varfërinë e gëzimit
— e gëzimi i paktë hipur në orteqe...
në krepë e lugje

pyjeve të zhveshur.

Pastaj rridhte helmi.

Në lumin e jetës çka nuk dilte në brigje
shtrohej urë dhe e nxirrte teli.

Nga themel i shpirtit nëpër urën tënde
shaluar kuajve

e shpesh më këmbë

shfaqej ajka e këtyre trojeve.

Në vërshime motesh,

ndërrime brezash

për ta rrije rojë.

Me telat gjithnjë lirinë mbake ndezur,
se në guvën tënde mbika e vërteta.
Prej dhjetëra shekujsh
gjëmon teli i sertë
për trimëritë e vjetra e të reja.

2000000000

[Faint, illegible text, possibly bleed-through from the reverse side of the page]

KTHIMI I NIZAMËVE

Agimet e sëmura, muzgjet e rënda,
me paqe kaq të lodhshme plot vapë
— sa lufta perandorake

brenin ditët dhe netët tona prej malli,
kthimin tonë bluanin pak ngã pak.

E nga mielli i brengës së lashtë
mbruhej buka pesëqindvjeçe.

E nga kjo brengë një pjesë e vrazhdë
binte si brymë mbi uniformën e vjetër,
mbi durimin e dorës,
metalin e ftohtë të armës,
mbi flokët e dendur, të verdhë,
në plagët e shtatit dhe pipat e ëndrrës
që ushqente gjithnjë zemra.

Po zemra' ish e thellë. S'e arrinte krahneza
as me gurë, e as të përpjetave
me sharjet e kamxhikëve, oficerëve
e vdekjet e verbëra të shokëve.

Tepër thellë. Natë për natë dëgjonte
kollën e mbytur të kullës së gurtë
tek ruante kthimin tonë,
vendin e zbrazët në sofër dhe hisen e vatrës
me flakën e pritjes së ngrohtë.

S'e arrinte acari. Brenda saj plepi bleroi gjithnjë
e pranë plepit, si jeta, kroi kurrë s'u shter.
Vasha këtu i mbush me ujë të ri bucelat
dhe dashuri në trimin qet përherë.

VDEKJA E BAJRAM CURRIT

Sa e rëndë qenka të përkulesh
mbi kryet e bardha, por mos shtrihesh
e me duart e tua të zësh dorën tënde,
zemrën tënde,
me duart e tua.
Veten të ngresh në këmbë.

Gjëma ther në palcë të dheut.
Nga bimëz e brishtë gjëma
gjer te flamuri.

Lugjesh me orteqe,
gropash me borë,
Malet mbakan malin Bajram Curri!

ISË BOLEINI

Sulltanë dhe kralë, ar e thika të helmëta,
nën puhizë lavdesh e lulesh, vargonj titujsh,
aziatikë të bujshëm, oferta të pronave — burgje
të ndoqën, gjaku im, këmba-këmbës të ndoqën;
nata dhe pabesia shokët e tyre.

Por natën besa jonë të mbronte,
ditën trimëria.

Se ne flisnim me zërin tënd, o Isë,
e ti me tonin flisje
e kurrë s'diti të na përbuzë toka e fisme.
Gjaku yt hyri tek i yni, nga Urë e Podgoricës,¹⁾
na jep gjithnjë emrin
e besës dhe trimërisë sate.

1) Vendi ku ra heroi

Më fort ndriti ylli i luftës
dhe i shpresës sonë te liria.
Ata u drodhën, moj pushkë e ngrehur,
u drodh pabesia
në thonjtë e tyre të errët.
Dhe të ndoqën, ylli im, ty dhe shpresën,
në nëntëdhjetë ura të qëlluan
dhe vranë vetveten.

AZEM GALICA

Ti shkove te Muji,, te Halili.
Prej frymës sate u ndezën rrugët, bari i livadheve
dhe ahishtet pa kohë rrëzuan hijet e tyre.
Shkove te zjarri i moçëm,
mijëravjeçar ai. Moshatar me lahutën,
me krenarinë e hidhur të pishave,
me emrin tonë moshatar.
Vdekja ty s'të prek dot, zjarri im!
Ha Ganiqe Galanin¹⁾ ajo, Kostë Vojvodën e
Çubriloviçin.
Veten ha vdekja, se bukur larg ti shkove.
Nuk të mbërrin atje në zemër të tokës.
Fare larg! Mu në zemrën e kombit
keni shtruar sofrën tuaj rreptësisht demokratike;
krejt për shoq' nga një dash,

1) Ganiqe Galani — kundërshtar i kreshnikut Mujë

me mjaltë ngrirë mustaqet, drejt përperjetë,
si shpata të kuqërremta, të zhveshura.
E rrinë përgjojnë Muji e Halili,
vërejnë
si rrjedh pikë-pikë gjaku
mureve të shpellës,
gurëve thinjakë e të mëdhenj të qëndresës.
Me ta bashkë edhe ti, Azem Galica. Përgjon.

SHTJEFËN GJEÇOVI

Tek ai jam në shtëpinë time
me zjarr, ku mësoj dashurinë
për emrin tim të vjetër,
njerëzit e mi.

Rruga është bukur e gjatë
e për t'u mbajtur më ka lënë
shkopin e tij.

DUKE PARË NJË VALLE TË LUMËS

Veshur në të zeza, në të bardha,
ne e mbyllim derën e kullës,
e i hapim udhët për dasma
vit për vit duke i rënë luftës.

Lumë i kuq nëpër rrëmbe
kah liria gjithnjë rrjedh.
Nëpër terr kush të mbjellë gjemba
do të ketë zjarr e vrer.

Se qysh shkel varret e vjetra
more kral, bir i kralicës?!
Vend i shkretë veç gurë e shkrep
e prapë ja, zëri i martinës.

Dhe ty, mik, të dhembka shpirti
që më sheh duke shqepuar.
Trupin tim diku ma ndanë,
po unë kurrë s'jam ndaluar.

SHIWI

N'zembrën time unë u mbajta
e në plagën faqebardhë;
mbeti sheshit trup i kralit
në sy të botës i pavarr.

Mund të dridhej gjoks i malit,
toka ndoshta u lëkund,
por s'i vjen vdekja shqiptarit,
lind ai nëpër furtunë.

LUMË, 1913

poemë

Po lulonin thanat, pas dimrit të gjatë
ndihej hapi i ndrojtur i pranverës.
Netve, diku larg, deti gjëmonte,
malet po gatiteshin për një mot të egër.

Krap-krup... hije e frikshme
trokiste 1913-ta salloneve plot shkëlqim
nën firma mbretërishe,
kancelarësh,
hartave copëtonte vendin tim.

Kërkëllinin pastaj qerret e luftës,
por ne zgjuar gjithnjë qemë në atë lojë
e lukuni e stepave zbrapsej
me një copë Shqipërie në gojë.

Evropa lëvrinte nëpër mjegull,
sytë e saj të shqyer,

të etur

si dy puse të shterur
prisnin gjakun tonë të rridhte,
cungimin e krahëve,

të këmbëve.

(Prapa heroizmit tonë
qe strukur dikur ajo dhelpër.)

E trupi ynë pakuar në luftëra,
ndjeu ndarjen e tmerrshme,
u gjakosën lulet e thanës,
pranvera na ngriu në deje.

* * *

Gjyshi im po hidhte farën pas qeve,
misrin e verdhë në brazda.

Dielli venitej pas një reje,
fluturonin rreth e qark korba.

Po ç'thoshte kështu Drini i Bardhë,
pushkës ç'i murmuronte i shqetësuar?
Sytë e mëdhenj, të lëngëzuar të qeve,
diçka pyesnin të trishtuar.

Pastaj klithje njerëzish e kafshësh,
kuisje qensh,
me potkonj të rëndë po rendnin
dëshira të vjetra carësh,
lakmi mijëvjeçare kralësh.

Si nën një çadër gjigante të çjerrë
nxihet fusha nën hije shapkash,
nën fushën e shkrifët nxihet fara
e diku më thellë —
varret e lashta.

Gjyshit tim dielli iu err,
Pushtrika, Pikëllima u shiembën,
preku barkun e prerë,
dëgjoi trokun e çmendur të armiqve.

Nga gjiri i dheut betimi dilka:
pabesia e armikut të egër
do të lëkundet në majën e lisave!

* * *

Armiku s'dëgjoka betimin e maleve të mia,
asnjëherë s'ka kuptuar si betohen malet.
Shkel luginën nën vështrimin e tyre,
rrënon arat,
mbjell vdekjen,
s'ndalet.

Jo, s'e ndalka atë Përbregu,
dyqind kasolleve të varfra,
duhma e tij rrëzon pullazet,
therr fëmijën në barkun e nënës
pastaj tallet.

Krap-krup si pyka mes maleve.

Krap-krup
kërcasin eshtrat e të vdekurve,
kërcasin eshtrat e të rënëve.

Veç shih si u rritkan flakët në maja,
pa shih si u ndizkan zjarret!

Ç'bimë e keqe do të mbijë këtu?
Nxijnë rrugët,
fushat,
fshatrat,

Ç'ngjyrë e keqe, ç'erë e rëndë,
gjer te pragjet,
gjer te vatrat me prush të nxehtë,
kosa të mprehta.

Vërtitini në lartësinë e shpatullave
mbi bimën e keqe,
mbi vetë vdekjen, vërtitini
prushin e kosën
pragje të shtrenjta, vatra të dashura.

Qenkan ngritur heronjtë nga balta,
rend gjyshi im siç ecte më parë.
Si vetëtimë Përbregu i djegur
me të palindurit në ballë.

Armiku s'po shihka asgjë,
armiku s'dëgjoka asgjë?!
S'e lë tymi i zi për të parë,
klithmat e të palindurve për të dëgjuar.

Verbuar, shurdhuar
ecka mes maleve,
krup-krup,
drejt vdekjes ecka.

* * *

Rreth e qark vetëtin.
Bubullin —
dufi i maleve.

Edhe trarët e djegur
ashtu me flakë
qëllojnë e s'nginjen.

Grykë e Lumës po rrjedh gjak,
Grykë e Lumës po ushton
e i thotë Drinit ndihmomë pak.
Uji im është i cekët
trupat e tyre të rëndë.

Pret Drini Lumën,
rrjedhën ndali
(si mund të rridhte i qetë).

Nën hakmarrjen e valëve
gjurmë e ndyrë e armikut
copëtohet për në det.

* * *
Luluan thanat pas dimrit të gjatë,
kudo fytyra e trishtë e pranverës,
në veshë na' mungontë gjëmimi i detit,
fare pranë ngërdheshej moti i egër.

Thikë e pabesë e Evropës
bie mbi malet e mia,
fushat,
Sytë e saj të shqyer,
të etur
si dy puse të shterur
nga gjaku ynë mbushën.

E trupi ynë pakuar në luftërë
ndien dhëmbët e tmerrshëm.
U gjakosën lulët e thanës
pranvera na ngriu në dejë.

Tani po hartohet Traktati i Londrës,
lakmia donte dhe më të ngopej
(gërmat e nxirra do të hapnin gojën).

Po unë ku i kam krahët, medet,
ku i kam këmbët?

Si mund të shkojmë tash te njëri-tjetri,
na i kanë rrëzuar urat.

— Por ne do të shtrojmë zemrat.

Thonë se na e kanë ndaluar
shtrëngimin e duarve,
lirinë për të përçafuar,
mbrojtur
krejtësisht vetveten.

— Por ne kemi rrënjët.

Rrënjët janë të thella,
degëzime nervash nëpër trupin tonë,
degëzime rrëfimesh nëpër tokë,
i njëjti gjak gurgullon i ngrohtë
nëpër trup,
krahë,
kokë.

Si mund të harrohet emri i nënës!
Në rrënjët e saj minierë heronjsh,

jo nuk treten ato ndër kohëra,
flakin tej çdo peshë vargonjsh.

Si gjithnjë
te njëri-tjetri
dalim,

hyjmë.

Tingëllon lahuta kreshnike,
pa shih ëndrrat tona si mbijnë.

Ke parë 1913 si po dejet bora maleve,
fort mirë ka dëgjuar për vërshimin e lumenjve.
Asgjë s'po e ndalka lumin e thanave,
sa i sigurt qenka ky hap i pranverave!

PËRMBAJTJA

Në këtë copëz tokë	3
Na u rritën ëndrrat	5
E përditshme	7
Drini i Bardhë (poemë)	8
Liçeni i dritës	18
Legjenda e emrit	19
Babai	21
Shiu është atje larg	23
Më ka marrë malli	24
Peizazh dimri	25
Mars	27
Me autobusin e parë të mëngjesit	28
Ditët dhe netët e një kantieri	30
Bjeshkët e Nemuna përcjellin të rënët	31
Banorët e parë të Kukësit të Ri	32
Dëshmorit Gani	33
Guri i Shpuar	34
Mos e prek mëngjesin tim	36
Mesnatë e dashuruar dhjetori	38
Në udhën e vjetër	39
Po nuk erdhe	41
Fustani i bardhë	43
Ndryshe s'do të flisja kështu	44
Bisedë telefonike	46

Himnari 1980	47
Kthjelltësia e maleve	48
Lahutës	49
Kthimi i nizamëve	51
Vdekja e Bajram Currit	53
Isë Boletini	54
Azem Galica	56
Shtjefën Gjeçovi	58
Duke parë një valle të Lumës	59
Lumë, 1913 (poemë)	61

1980

1980

[Red: I. Thoma] T. - Naim Fr-

1980

78

(E. n.) dhe

(E. v.): 001 000 1

Don

1980 1000 kopje format 70x100 32

KOMITATI POLIGRAFIK SHQIPTARISHTË E TIRANËS 1980